

=====

Fenomeni i dështimit të bizneseve

Driton Sylqa
Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”

Abstrakti

Në literaturën e sotme debatohen mjaft shumë shkaqet e dështimit të bizneseve në përgjithësi e sidomos të biznesit të vogël për shkak të rëndësisë dhe vendit që ai zë në kuadrin e ekonomisë kombëtare të një vendi. Në Kosovë ekziston një numër i madh i bizneseve të reja të regjistruara, por shumica prej tyre nuk kanë arritur t’iu bëjnë ballë ndryshimeve ekonomike të tregut, konkurrencës, ambientit e shumë barrierave tjera. Shpesh herë shkak i falimentimit janë edhe mungesa e eksperiencës, menaxhimi i dobët, marketingu i varfër, si edhe vendimet e gabuara të cilat qojnë në rrugën e dështimit. Për të konstatuar shkaqet e dështimit janë konsultuar të dhënat statistikore të vitit 2012, 2013, 2014, dhe 2015 lidhur me regjistrimin dhe dështimin e bizneseve të reja. Këto të dhëna analizohen, si dhe krahasohen me rezultatet e hulumtimit. Në përmbyllje jepen disa rekomandime të përgjithshme, e sidomos për bizneset të cilave ju kërcënohet mbijetesa, që t’ju kushtojnë vëmendje dhe të merren parasysh gjatë zhvillimit dhe rritjes së tyre. Mesazhi i këtij punimi është që bizneset e brishta të sensibilizohen për vështirësitë të cilat i kanosen atyre, në mënyrë që më pastaj të gjejnë një zgjidhje adekuate dhe me kohë për problemet eventuale me të cilat mund të ballafaqohet.

Fjalët kyçe: Biznesi, Dështimi, Falimentimi, Faktorët, Menaxhimi, Udhëheqja, Vendimarrja.

1. Problematika e punimit

Zhvillimi i aktivitetit të organizatave të biznesit dhe marrja e vendimeve menaxheriale realizohen nën trysinë e vazhdueshme të një diapazoni të gjerë forcash e faktorësh të mjedisit të jashtëm, të cilët kanë një influencë relativisht të madhe në mbijetesën dhe perspektiven e zhvillimit të ardhshëm të tyre. Në spektrin e faktorëve të mjedisit dallohen dy grupe të mëdha, të cilët në mjaft raste veprojnë

=====

në mënyrë të ndërthurur midis tyre, faktorët e jashtëm dhe të brendshëm.

Ekspert të ndryshëm të biznesit thonë se ka disa arsye që të qojnë në dështimin e biznesit. Dy studiues të njohur në fushën e biznesit, Dun dhe Broadstreet, kanë zbuluar që bizneset dështojnë çdo vit për arsye shumë të ngjashme. Ndër shkaqet kryesore të dështimit të biznesit janë: paaftësia për të drejtuar një biznes psikologjikisht, moralisht ose profesionalisht (Avdijaj, E.2015).

Shpesh shkaqet e dështimit të biznesit identifikohen me menaxhimin e keq. Por vështirësia e hyrjes në biznes dhe faza e parë e rritjes kanë treguar se janë shkaqet kryesore, ndërsa menaxhimi i keq është thjesht efekti në lidhjen shkak-pasojë. Ndër disa faktorë të njohur dhe të përmendur në literaturë tanimë janë: (Robo, M. dhe Xhavana, 2012)

- Mungesa e eksperiencës menaxheriale;
- Mungesa e njohurive në fushën e marketingut, financës, prodhimit dhe blerjes;
- Konkurrenca e ashpër dhe jo lojale: pamundësia për të përballuar konkurrentet, të cilët shpesh janë të pamëshirshëm;
- Ekonomia informale bën presion të vazhdueshëm tek ajo formale;
- Brishtësia financiare e bizneseve të vogla dhe kushtet jo të favorshme kreditore;
- Vëmendje tepër e vogël për biznesin, për shkak të zakoneve të këqija, shëndetit të dobët, vështirësive bashkëshortore;
- Mashtrimi dhe sjellja jo etike;
- Burokracia qeveritare dhe rregullat e shumta që pengojnë rritjen e biznesit, etj.
- Shkaqe madhore: zjarri, përmytje, vjedhje, grevat e punonjësve;

Ndonëse, nga shkaqet e numërta në literaturë, në varësi të madhe të dështimit të bizneseve luajnë dhe faktorët real të një ekonomie kombëtare, pozicionit të saj në raport me ekonominë e tjera, politikat fiskale, kreditore dhe ekonomike të një shoqërie, mentalitetit dhe faktorëve kulturor të asaj shoqërie, etj. Kjo do të thotë se jo secili biznes i kanoset të njëjtat rreziqe që mund të shpijnë deri te rënia. Prandaj, secili biznes duhet të studiojë faktorët rrethanorë objektiv të tij, në mënyrë që së pari të vetëdijesohet për kanosjet e më pastaj të gjejë një zgjidhje të përshtatshme për t'i kapërcyer ato. Në këtë spektër, roli udhëheqës bëhet primar, përveç kapacitetit financiar për të realizuar objektivat përkatëse të biznesit.

Pyetja hulumtuese

Cilat janë arsyet e përbashkëta të dështimit të bizneseve në Kosovë?

Hipotezat

Mbi pyetjen hulumtuese, ngritën edhe hipotezat të formuluar si më poshtë:

- Hipoteza 1: Brishtësia financiare është faktor kryesor i dështimit të bizneseve.
- Hipoteza 2: Inkompetenca udhëheqëse çon në dështimin e bizneseve.

=====

Metodologjia e kërkimit

Për të realizuar këtë projekt janë përdorur metoda kërkimore të të dhënave empirike nga statistikat zyrtare të përgjithshme të regjistrimit, përkatësisht shuarjes së bizneseve në Kosovë. Kërkimi sekondar është realizuar nga hulumtimi i 50 bizneseve në regjionin e Pejës përmes anketës në mënyrë që të mund të pasqyrohet sa më mirë tematika e punimit. Analiza e të dhënave është bërë sipas metodës kualitative, d.m.th. autori përmbledh dhe interpreton rezultatet për të vërtetuar / hedhur poshtë hipotezat e ngritura.

2. Korniza teorike

Faktorët e mjedisit të jashtëm me influencë në ecurinë e bizneseve

Zhvillimi i aktivitetit të organizatave të biznesit dhe marrja e vendimeve menaxheriale realizohen nën tryshinë e vazhdueshme të një diapazoni të gjerë forcash e faktorësh të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët kanë një influencë relativisht të madhe në mbijetesën dhe perspektiven e zhvillimit të ardhshëm të tyre. Mjedis i jashtëm inkuadron atë grup makro faktorësh që pasqyron kushtet dhe tendencat e shoqërisë brenda se cilës vepron organizata e biznesit. Në këtë grup inkuadrohen një sërë faktorësh ku me të rëndësishmit janë:

- Faktorët politiko-ligjorë

Secili biznes i caktuar, pavarësisht veprimtarisë, madhësisë dhe formës së tij ligjore, duhet të ketë marrëdhënie me qeverinë, qofte atë lokale ose atë qendrore. Një ndërmarrje duhet në radhë të parë t'i respektojë normat juridike në aspekt të veprimeve të saj dhe në radhë të dytë të jetë e ligjshme në aspektin e shlyerjes së të gjitha obligimeve financiar ndaj shtetit. Politika, pothuajse e ka rolin kryesor në ndryshimin e një gjendje të caktuar ekonomike në një vend. Një politikë e cila inkurajon iniciativën private, favorizon tregtinë e jashtme, mundëson transferimin e pronës shoqërore tek ajo private, krijon një ambient të sigurt për investitorët potencial e veçanërisht për ata të jashtëm, është një politikë jetike e një vendi që përmes saj bizneset e këtij vendi arrijnë prosperitetin e tyre, rimëkëmbjen ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik të atij shteti (I. Worthing & Ch.Britton, 2005).

- Faktorët ekonomikë

Faktorët ekonomikë zakonisht manifestohen nëpërmes ndryshimeve në treg, rritjes reale ekonomike, normave të interesit, konkurrencës, papunësisë, etj.

=====

Rritja reale ekonomike ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e madhësisë për mallra dhe shërbime. Zakonisht kur shënohet rritja ekonomike, rriten të gjitha aktivitetet ekonomike që përfshijnë edhe rritjen e fuqisë blerëse, si dhe rritjen e punësimit. Në rastet kur kemi recension ekonomik atëherë kemi edhe rënie të kërkesës për mallra dhe shërbime, kështu që si rezultat i kësaj bizneset ballafaqohen me vështirësi, e më pastaj me falimentim. (I.Mustafa, 2007).

- Faktorët social-kulturorë

Mjedisi social-kulturor përbehet nga normat, zakonet, qëndrimet dhe sjellja që janë karakteristika të një grupi njerëzish apo e një shoqërie të caktuar. Këta elementë ndryshojnë për njerëz që jetojnë në vende apo zona të ndryshme gjeografike. Prandaj menaxherët, për të qenë të suksesshëm në biznesin e tyre, duhet të kenë parasysh këtë faktorë. Ekonomia e tregut tek ne krijoi oportunitete të reja për bizneset, bëri që të hyjnë mallra dhe shërbime atraktive duke krijuar kështu mundësi reale që edhe qëndrimet/sjelljet e njerëzve të pësojnë ndryshime Këto ndryshime sollën si pasojë edhe rritjen e kërkesës për produkte e shërbime (B.Koleci, 2008).

- Faktorët teknologjikë

Teknologjia është një koncept i gjerë që përfshin njohuritë për veglat dhe profesionet, në funksion të kontrollimit dhe të përshtatjes së njeriut me rrethanat në mjedisin jetësor dhe përpurthje me nevojat e tij (A.Xhavara, 2012). Me të vëmendshëm ndaj ndryshimeve teknologjike duhet të jenë sidomos firmat që operojnë në ato fusha të industrisë ku edhe inovacionet janë më të shpeshta, sikurse është p.sh. industria elektronike (B.Koleci, 2008).

- Faktori ndërkombëtar

Objekti i hulumtimit të ekonomisë ndërkombëtare përbehet nga problematikat e bashkëveprimit ekonomik të shteteve sovranë. Ekonomia ndërkombëtare përdor metoda të njëjta themelore të analizës si dhe degët tjera të ekonomisë, ngase motivet dhe sjellja e individit në tregtinë ndërkombëtare janë identike me ato në transaksionet vendore. (Paul R.Krugman, 2010). Firmat këtu te ne importojnë pajisje, mallra e teknologji të huaja dhe eksportojnë mallra tradicionale e lëndë të para. Të tilla transaksione kryhen sepse çdo vend ka disa produkte që i prodhon me një avantazh të caktuar ekonomik.

- Faktorët e mjedisit të brendshëm me influencë në ecurinë e bizneseve

- Klientët

Klientët janë një nga faktorët kyç të suksesit e një biznesi. Për vet rëndësinë

=====

që ata kanë janë shpesh quhen mbretër të biznesit. Një faktor i rëndësishëm që duhet marrë në konsiderate është madhësia e parave që kanë në dispozicion për të shpenzuar njerëzit, të klasifikuara sipas grup-moshave, por edhe sipas llojeve të mallrave apo shërbimeve, gjë që i ndihmon firmat për të hartuar një strategji të drejtë marketingu. Klientët e firmave janë jo vetëm individët por edhe organizatat, të cilat produktet e blera mund ti përdorin për përpunim të mëtejshëm apo për qëllime të tjera (M.Robo, 2012).

- Konkurrentet

Konkurrentet e një organizate biznesi janë ato firma që u ofrojnë klientëve mallra e shërbime të njëjta apo produkte, shërbime alternative. Organizatat e biznesit jo vetëm duhet të njohin se cilët janë konkurrentët aktual, por edhe konkurrentët potenciale, të cilët mund të futen në treg në të ardhmen. Nga ana tjetër, ato duhet të jenë në dijeni të gjendjes reale të konkurrentëve me qëllim që të bëjnë ndryshimet e nevojshme në teknologji, organizim dhe në përgatitjen e marketingut e produkteve.

- Furnitorët

Furnitorët e një organizate janë ato firma apo individë, të cilët i ofrojnë asaj burime të tilla si lende të pare, produkte apo shërbime të cilat i duhen organizatës për të realizuar aktivitetin e saj. Aktualisht konkurrenca botërore po e ndryshon këtë pikëpamje, sepse kompanitë e ndryshme po e zbulojnë që ato janë me të afta të reduktojnë koston duke zvogëluar numrin e furnitorëve me të cilët lidhet kontrata. Por nga ana tjetër duhet të pohoje që ekziston edhe rreziku që furnitorët t'i diktojnë prodhuesit kushtet e tyre. Në fakte, çmimi që caktojnë furnitorët, afati i lëvrimit dhe cilësia e produkteve janë gjera të rëndësishme në të cilat e përqendrojnë vëmendjen menaxherët.

- Personeli

Fuqia punonjëse e një organizate përbehet nga të gjithë ata individë të cilët potencialisht mund të punësohen prej saj. Rendësi të veçantë për firmat e biznesit ka madhësia e kësaj oferte, cilësia dhe çmimi i fuqisë punonjëse si dhe aftësia e menaxherëve për të tërhequr punonjës kompetentë, të cilët trajnohen, trajtohen dhe motivohen mirë, për të kontribuar në rezultatet e firmës.

Partnerët afarist

Partneret e një organizate janë ato firma biznesi të cilët bien dakord të punojnë së bashku për të realizuar një projekt të përbashkët duke ndare, sipas kushteve të pranuar nga të gjithë, rrezikun dhe përfitimet e projektit. Sot ne bote partneriteti nëpërmjet "joint-ventures" ka marrë përmasa të konsiderueshëm.

=====

- Sindikatat

Sindikatat janë ato organizata qe veprojnë brenda një firme apo në kuadër të një dege të industrisë si përfaqësuese dhe mbrojtëse e interesave të punonjësve. Sindikatat, në vendet e zhvilluara kanë një influencë relativisht të madhe mbi organizatat e biznesit. Ato duke qenë një element i rëndësishëm i mjedisit, duhet të mbahen në konsideratë nga menaxherët, si në momentin e përcaktimit të objektivave, ashtu dhe në procesin e marrjes së vendimeve strategjike.

3. Të dhëna statistikore mbi strukturën e bizneseve në Kosovë

Numri më i madh i ndërmarrjeve në Kosovë, janë tregti me 16 091 ndërmarrje, ose shprehur në përqindje (55.4%), industria përpunuese 3736 (12.9%), akomodimit dhe aktiviteteve të shërbimeve me ushqim me 3126 (10.8%), ndërtimtarisë me 2094 (7.2%), si dhe shërbimeve biznesore dhe shërbimeve të tjera me 1 897 (6.5%). Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës numri total i të punësuarve arrin shifrën 149 886, prej të cilëve sektori i tregtisë, i cili mban primatin përbën rreth 57,379 të punësuar, ose shprehur në përqindje (38.3%). Karakteristikë tjetër që vlen të përmendet është edhe qarkullimi i realizuar nga ndërmarrjet, e që prapë dominon tregtia me një pjesëmarrje prej 55.7%, industria përpunuese me 11.8%, ndërtimtaria me 10.5%, kurse sektorët e tjerë të veprimtarive ekonomike rezultojnë me një përqindje më të vogël të qarkullimit.

3.1 Ecuria e shuarjes së bizneseve në vitin 2012

Jo të gjitha bizneset e reja kanë fatin të mbijetojnë dhe të zhvillohen. Nga 9592 biznese të regjistruara në Kosovë në vitin 2012, janë shuar 1081 prej tyre (Agjencia e Statistikave të Kosovës). Bizneset shuhën realisht apo falimentojnë, por ligjërisht nuk shuhën për shkak se procedurat e likuidimit janë shumë të vështira dhe marrin kohë.



Fig 1. Numri i ndërmarrjeve të shuara ne vitin 2012

Sipas të dhënave zyrtare të Aleancës Kosovare të Biznesit, në Kosovë numri i bizneseve të shuara është trefish më i lartë se sa i atyre që paraqiten zyrtarisht në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Procedurat e përcaktuara për shuarjen e bizneseve, sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë janë të domosdoshme për tu implementuar (A.Shahini, 2014).

Mungesa e politikave zhvillimore dhe qasja e kufizuar në financa, vlerësohen të jenë disa nga barrierat që çojnë në vështirësi të mëdha bizneset dhe të cilat mund të jenë si faktorë kontribuues në falimentimin e shumë ndërmarrjeve.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë deklaron hapur se për të ndihmuar bizneset ata vazhdimisht kanë bërë reforma të shumta. Reformat e bëra, kanë qenë eliminimi i lejes, reduktimi i numrit të dokumenteve për eksport, etj. Po ashtu, njëra nga lehtësirat që iu është bërë bizneseve, ka të bëjë edhe me regjistrimin e bizneseve, i cili tani bëhet pa pagesë dhe me procedurë të thjeshtëzuar. Sidoqoftë, përfaqësues të bizneseve trumbetojnë se në mungesë të përkrahjes institucionale, bizneset në Kosovë po shuhën.

Shuarja e bizneseve në vitin 2013

Të dhënat zyrtare tregojnë se nga 9421 biznese sa janë regjistruar në vitin 2013 mbi 1000 biznese janë mbyllur, ndonëse arsyet e mbylljes janë raportuar të jenë vullnetare. Vlerësohet zyrtarisht se numri prej mbi 1000 bizneseve të shuara është shumë i lartë, krahasuar me numrin e bizneseve aktive në vend. Ky është një indikator që paraqet ambientin e pavolitshëm të të bërit biznesi në Kosovë. Konsideron se numri më i madh i bizneseve që mbyllen janë biznese të vogla, pasi që kompanitë e mëdha dominojnë mbi bizneset e vogla.

Në vijim paraqitet grafiku me të dhënat krahasimore për lindjen dhe shuarjen e bizneseve në periudhën 2009 e deri më 2015 për secilin tre-mujor.




Fig 2. Numri i ndërmarrjeve të reja dhe atyre të shuara 2009-2015

Një nga ndërmarrësit e falimentuar fajëson ngarkesat e larta tatimore që e kanë detyruar të çregjistrojë biznesin e tij, pasi më shumë është dashur të paguajë obligime, sesa që ka fituar. Por, ekspertët ekonomik kanë argumentuar se kamatat e larta të kredive, ekonomia joligjore, mungesa e një angazhimi më serioz të autoriteteve kompetente karshi sektorit privat, janë disa nga arsyet e shuarjes së bizneseve.

Sipas një hulumtimi që ka bërë AKB-ja, në vitin 2014, rezulton se një ndër


arsyet kryesore me ndikim pozitiv në falimentimin e bizneseve, është mos përmbushja e detyrimeve ndaj bankave komerciale. Konkurrenca jo legale që bëhet në të shumtën e rasteve është pasojë e funksionimit jo të mirë të institucioneve kryesore që kanë për qëllim të mbrojnë këtë konkurrencë. Bizneset e vogla ballafaqohen me mungesë të përvojës. Edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, theksojnë se politikat jo të favorshme për zhvillimin e sektorit privat, ekonomia joligjore dhe sistemi bankar, paraqiten si pengesa kryesore që çojnë drejt falimentimit të bizneseve në vend. Në anën tjetër, në raportin e fundit të Bankës Botërore, Kosova është radhitur më mirë në fushën e të bërit biznes. Sido që të jetë trendi i investimeve të huaja në Kosovë ka shënuar rënie përgjatë viteve të fundit.

3.3. Dukuria e shuarjes në vitin 2014

Shuarja e bizneseve në Kosovë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Agjencia për Regjistrimin Bizneseve ka raportuar se vetëm brenda pesë muajve të parë, 652 kompani të ndryshme në Kosovë kanë shuar biznesin e tyre, gjë që është shqetësuese pasi trendi është në rritje. Arsyet kryesore për këtë dukuri i janë atribuuar ambientit të pafavorshëm biznesor, mungesës së qasjes në kapital, politikave të pafavorshme fiskale, si dhe të ekonomia joformale.

Sipas tabelës në vijim, në të cilën janë paraqitur të dhënat e bizneseve të shuara sipas komunave në Kosovë përgjatë tremujorit të dytë, është

Numri i ndërmarrjeve ekonomike të shuara sipas komunave në TM2 2014



=====

evidente që numri më i madh i ndërmarrjeve të shuara është në Prishtinë, pastaj Prizren, Gjakovë, etj. Peja, me gjithsej 23 biznese të shuara ka një rradhitje modeste në raport me komunat e tjera. Supozohet se kjo radhitje vë për shkak të numrit më të madh të bizneseve të regjistruara në krahasim me komunat e tjera.

Fig 1: Numri i ndërmarrjeve të shuara sipas komunave

Shuarja e bizneseve duhet të jetë sinjal alarmues për institucionet kosovare, në mënyrë që të ndërmarrin hapa konkretë për ta përkrahur sektorin privat. Me shuarjen e bizneseve, shuhen shumë vende të punës, çka rrjedhimisht ndikon edhe në rritjen e shkallës së papunësisë në vend, e cila është raportuar të jetë rreth 30.9 për qind. (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015).

Numri i përgjithshëm i bizneseve që figurojnë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është mbi 130 mijë. Prej tyre 99.1 për qind u takojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Prandaj, ambienti i të bërit biznes si duket nuk është mjaft i favorshëm për këtë kategori, e sidomos për ndërmarrjet mikro. Duke u nisur nga faktorë të përgjithshëm, mungesa e lehtësirave fiskale, qasja në financa që është shumë e vështirë për këtë kategori të bizneseve, normat tatimore që në dy vitet e fundit janë përkeqësuar, sidomos për kategorinë e bizneseve të shërbimeve, ku është shënuar rritje tatimore prej 5 deri në 9 për qind.

Të dhënat e bizneseve të reja të vitit 2015

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 gjithsej janë regjistruar 2582 ndërmarrje, që shënon një rritje domethënëse në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, respektivisht 407 ndërmarrje apo 18.7% më shumë ndërmarrje të reja të regjistruara. Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: tregtia me 784 ndërmarrje të reja (30.4%), prodhim me 276 (10.7%), dhe sektorët e tjerë të gjithë së bashku me rreth 10%.

Kategoria nga 1-4 të punësuar përbën rreth 2507 ndërmarrje apo 97.1% të ndërmarrjeve të reja, gjersa të gjitha kategoritë e tjera me rreth 3%. Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të reja në nivel të komunave si zakonisht dominon Prishtina me 608 ndërmarrje të reja (23.5%), Prizreni me 193 (7.5%), Ferizaj me 190 (7.4%), Peja me 158 (6.1%), etj. Në anën tjetër, numër zyrtar të ndërmarrjeve të shuara nuk ka ende. (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015).

=====

Rezultatet e hulumtimit

Bizneset e hulumtuara kanë këtë strukturë: ndërmarrjet tregtare - 56%; ndërmarrjet prodhuese - 20%; ndërmarrjet shërbyese - 24%.

Faktorët e jashtëm

Ekonomia informale dhe konkurrenca jolojale perceptohet si një problem serioz për dështimin e bizneseve. Respondentët mendojnë se është një kërcënim serioz që duhet marrë parasysh, kërcënim ky që po ndikon mesatarisht në falimentim të bizneseve. Shembull konkret në tregun e Pejës mund të marrim konvertimet e parasë që vazhdojnë të bëhen ilegalisht, me çrast këmbimoret e regjistruara arsyetojnë se tregtia ilegale është një nga faktorët kyç të dështimit të bizneseve të tyre. Në përgjithësi bizneset mendojnë se konkurrenca jolojale është ndër faktorët kryesor të falimentimit të bizneseve. Arsyeja se pse kjo konkurrencë lind, është se bizneset tregtojnë produkte për afërsisht të njëjta, me cilësi të dobët për dhe çmime më të lira që nxjerrin nga tregu bizneset e mirëfillta dhe të ndershme.

Sa i përket qeverisjes së pushtetit qendror dhe lokal mendohet se kjo është një shtyllë thelbësore e dështimeve të bizneseve të tyre. Nga 42% e të anketuarve mendojnë se është një faktor shumë i rëndësishëm dhe me 24% me një rendësi mesatare. Ndërkaq 32% të anketuarve mendojnë se ka pasur një qeverisje të mirë, duke dhënë subvencione dhe mbështetje në zhvillimin e prodhimtarisë së produkteve vendore.

Ekonomia e Kosovës ka një bilanc të pagesave mjaft negativ për vite me rradhë. Eksporti mbulon importin me vetëm 11% sipas të dhënave zyrtare. Në fakt, këto parametra janë të pamjaftueshme për të nxitur zhvillim ekonomik. Në pyetjen se a ndikojnë negativisht tek bizneset produktet e importuara, rreth 42% e të anketuarve mendojnë se ka një ndikim mesatar, ndërsa me 30% thonë se ka një ndikim të madh. Por realiteti i ekonomisë sonë është e kundërta, sipas hulumtimit haset me një përqindje më të madhe të ndërmarrjeve tregtare të cilat tregtojnë mallra të importuara, për shkak të kërkesës në treg. Prandaj, këto produkte bizneseve tregtare iu krijojnë të hyra.

Lidhur me taksat e larta, perceptimi është i moderuar. Impakti i taksës së lartë lidhet pozitivisht me dështimin në kuotën 70%. Respektivisht, 30% deklarojnë një ndikim të fuqishëm, 40% ndikim mesatar dhe të tjerët mendojnë se ndikimi i taksave të larta në mbylljen e bizneseve është fare i vogël.

Faktorët e brendshëm

Sipas rezultatit të hulumtimit, rreth 76% e respondentëve janë deklaruar se mungesa e burimeve financiare është një nga faktorët kryesor të dështimit të biznesit. Duke marr parasysh se pothuaj çdo biznes detyrohet të merr kredi nga bankat për të filluar apo vazhduar projektin e biznesit, konstatohet normat e larta të interesit është një indikator që bën që bizneset të hezitojnë në marrjen e kredive, gjersa ato që marrin mbajnë mbi supet e tyre një barrë të rëndë që jo-rallë shkakton rënien e biznesit e më pastaj edhe dështimin.

Rreth 68% e respondentëve mendojnë se planifikimi i dobët është shkak i dështimit të biznesit, gjersa pjesa tjetër deklarojnë se ky variabël ka një influencë të moderuar. Bizneset e kuptojnë rëndësinë e përpilimit të planit të biznesit, por efektiviteti i tij në botën reale duket ndryshe, gjatë kërkimit është vërejtur se bizneset nuk bëjnë planifikime afatgjata, të cilat pastaj pasqyrojnë numrin e madh të dështimeve të bizneseve.

Duke marrë parasysh se bizneset nuk i kushtojnë vëmendje aq të madhe marketingut të bizneseve të tyre është e çuditshme se me 48% të bizneseve të anketuara mendojnë se marketingu është shumë i rëndësishëm dhe një faktor kyç i dështimit të bizneseve, ani pse ato nuk e aplikojnë fushatën e marketingut. Me një përqindje më të vogël (12%) shprehen bizneset me përgjigjen pak, si dhe shumë pak me rreth 10% me arsyetimin se ata nuk e kanë aplikuar fare marketingun dhe megjithatë kanë arritur të përballojnë konkurrencën në treg dhe të krijojnë të hyra.

Sa i përket vendimmarrjes, rreth 64% e respondentëve mendojnë se ky variabël është një faktor thelbësor mbi dështimin e bizneseve, dhe me 10% mendojnë se ajo ndikon pak në dështimin e bizneseve. Çdo vendimmarrje i ka efektet e veta pozitive dhe negative, por duke pasur parasysh mungesën e informacioneve mbi menaxhimin e bizneseve, shpesh menaxherët e bizneseve marrin vendime të gabuara që mund të çojnë në falimentimin e bizneseve. Kjo ndodh për shkak të inkompetencës, mungesës së përvojës profesionale, si dhe inatit personal që ndërmarrësit lidhin me konkurrentët, klientët, partnerët afarist, etj.

Përfundimi

Nëse shfletojmë literaturë të autorëve të shquar nga bota e biznesit vërehet lehtë se hyrja në biznesi nuk është aq e lehtë se sa që mendohet. Problemet me të

=====

cilat ndeshen bizneset në fazat e para të të bërit biznes ndonjëherë janë aq të vështira sa edhe të papërballueshme, të cilat çojnë shpejtë në mbylljen e biznesit.

Legjislacioni adekuat dhe zbatimi i tij në praktikë ka rol kyç në përkrahjen e bizneseve. Hartimi i planeve të zhvillimit ekonomik nga qeveria duhet të përfshijë një spektër të gjerë të indikatorëve të cilët mbulojnë pjesën më të madhe të sektorëve në një shtet. Si një vend që ka nevojë për një zhvillim të hovshëm, të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik, Kosova nuk mund të presë të mësoj prej gabimeve të saj. Gabimet e vendeve tjera, sidomos vendeve me një situatë të ngjashme politike, sociale e mbi të gjithash ekonomike, duhet të shërbejnë si mësim sistematik në krijimin e politikave publike. Limitimi i tyre në indikatorë të përzgjedhur të suksesit mund të tingëllojnë mirë në raportet e institucioneve përkatëse, por praktika e gjertanishme ka treguar se ato nuk e përmirësojnë mjedisin e biznesit në Kosovë.

Ekonomia e Kosovës ka pasur një zhvillim pozitiv gjatë viteve të fundit sa i përket bilancit të bizneseve të reja të regjistruara. Me një mesatare mujore prej 2157 të bizneseve të regjistruara dhe me një mesatare prej 310 të bizneseve të shuara, ekonomia nuk do duhej të ishte aq keq. Sidoqoftë, edhe pse me një numër simbolik, numri i bizneseve të shuara ka një ndikim negativisht mbi procesin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Faktorët që po e shkaktojnë shuarjen e tyre janë mund të shumta në numër, si: mungesa e eksperiencës, planifikim i dobët, kushte të pavolitshme financimi, mungesa e njohurive në menaxhim, pamundësia për të realizuar fushatë adekuate të marketingut, produkte jo cilësore, konkurrencë e egër dhe e pandershme, mos zbatim i ligjeve dhe faktorë të tjerë që influencojnë mbylljen e bizneseve.

Rezultatet empirike të hulumtimit tregojnë se sipërmarrësit në një mënyrë janë të informuar mirë për faktorët në të dy mjediset, por realiteti tregon se edhe duke i njohur rreziqet e mundshme ndërmarrësit nuk aplikojnë teknikat për t'iu shmangur atyre rreziqeve të cilët janë të dëmshme dhe me pasoja për bizneset e tyre.

Në këtë mënyrë të dy hipotezat e ngritura, brishtësia financiare është faktor kryesor i dështimit të bizneseve, si dhe inkompetenca udhëheqëse çon në dështimin e bizneseve kanë rezultuar të jenë pjesërisht të sakta.

Pra, bizneset jo vetëm që kanë nevojë për përkrahje në kursin e tyre drejt rritjes, por ato duhet të zhvillojnë vetvetiu kapacitetet e tyre vepruese. Politika e punësimit me meritë, trajnimi dhe zhvillimi i personelit, ndarja e pronësisë nga menaxhimi, analiza e thukhtë e faktorëve të ndryshëm të biznesit, qasja me mirësi ndaj të gjithë partnerëve afarist, hartimi i planeve vepruese, identifikimi i hershëm i shanseve, etj, do të ishin rekomandime shumë të rëndësishme për tu konsideruar, si dhe pika strategjike për të investuar në to.

=====

Literatura

- Agjencia e statistikave të Kosovës – “Repertori statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë”, Prishtinë, 2015;
- Central Bank of Kosovo, Macroeconomic Developments Report, 2015;
- Britton Chris, Worthing Ian, “The business environment”, 2005;
- EBRD, Regional economic prospects in EBRD countries, January 2015;
- Decenzo Robbins. “Fundamentals of management – Essential concepts and applications”, 2011;
- Krugman Paul.R, Obstfeld Maurice. “International economics”, 2010;
- Koleci Baki, Reçica Fetah, Turkeshi Neritan. “Menaxhment (Bazat e menaxhimit)”, Prishtinë, 2008;
- Mustafa Isak, “Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor”, 2007;
- Robo, M. dhe Xhavara, A. “Bazat e Sipërmarrjes”, 2012;
- Statistical Agency of Kosovo, Foreign Trade Statistics, 2012;
- World Bank, Doing Business, Economy profile – Kosovo, 2015;
- World Bank, Global Economic Prospects, 2015;